



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:068794
Datë: 05.09.2024
Numri i dokumentit: 06124499

C-IV-14-7681

Ankuesi

Z I B nga Kaçaniku.
Përfaqësuar nga B I avokat në Prishtinë.

Kundër

E paditura

NSH.PMN,, Sharr” (në likuidim), e përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakërishtë- Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtaren Ganimete Puka, me 05 shtator. 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tersi si e pabazuar ankesa e ankuesit, dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI042-1088, dt.01.dhjetor.2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29.dhjetor. 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankese për rishikimin e Vendimit nr. GJI042-1088, dt.01.dhjetor.2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar që të kompensohen pagat e papaguara, për periudhën dt. 18.08.1997 deri me 30.09.1999, nga NSH PMN “ Sharr”. Ankuesi e kundërshton vendimin e AL-së për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit të së drejtës materiale, me pretendimin së AKP, gabimisht ka konstatuar se kërkesa e ankuesit është e parashkrua. Ankuesi pohoi se, me dhunë është larguar nga puna, dhe ka fituar procesin gjyqësorë me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C.nr.745/97, dt.25.03.1998, dhe përmes procedurës së përmbarimit, me aktvendimin P.nr.3/98, dt.17.08.1998, kundër vullnetit të punëdhënësit është

kthyer në punë. Ankuesi i propozon gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj në tersi si të bazuar dhe të obligohet e paditura në kompensimin e pagave të pa paguar për periudhën 18. gusht 1997, deri 30.shtator.1999, në shumën prej 11/174.00 €, më kamatë ligjor prej 1.117€, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 104.00€.

Ankuesi ka dorëzuar si provë: kopjen e vendimit , nr.2831/5, dt.11-I-1977, kopjen e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C.nr.745/97, dt.25.03.1998 , aktvendimin përbarimor, P.nr.3/98, dt.17.08.1998, si dhe vendimin e kundërshtuar të AL.

Me 26 prill 2017, e paditura parashtroi përgjigje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe së dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi së ankuesi nuk ka treguar së cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ankuesi i kërkon paga të papaguara për periudhën 18.08.1997, deri me 30.09.1999, në shumën prej 11.174.00 . E paditura pohoi së kërkesa e ankuesit është parashkruar dhe nuk ka prova që ankuesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare të parashkrimit, pra tri vite nga muaji gusht i vitit 1997. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 12.maj. 2017, i autorizuar i ankuesit ka dhënë përgjigjen ndaj mbrojtjes, duke kundërshtuar në tersi kundërshtimet e AKP, dhe mbet në tersi pranë pretendimeve dhe propozimeve të dhëna në ankesë, me propozim që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Me 31.maj. 2017, AKP, në kundërpërgjigje ka mbet në tersi ndaj kundërshtimeve dhe propozimeve të dhëna në mbrojtën me shkrim, me propozim që ankesat të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtresave të palëve.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se si në vijim:

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), është i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së. Dispozita e nenit 608 parashikon se kërkesat monetare që rrjedhin nga marrëdhënia e punës parashkruhen për 3 vite.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohen dispozitat e atij Ligji. Gjykata gjithashtu vëren se me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili hyri në fuqi më 01 nëntor 2010, në dispozitat e tij qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha Ligjeve ekzistuese të Punës në Kosovë. Megjithatë, ky Ligji parasheh parashkrim në lidhje me pagesat e të ardhurave, prandaj baza ligjore duhet kërkuar në legjislacionin në fuqi sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, të datës 12 dhjetor 1999 e cila siç u tha më lartë në nenin 1.1 pika b, parasheh si Ligj në fuqi në Kosovë legjislacionin i cili ishte në fuqi në Kosovë me 22 mars 1989.

Lidhur me parashkrimin rregullat e njëjta gjinden edhe në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978 i cili ishte në fuqi deri me hyrjen në fuqi më 19 dhjetor 2012 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së).

Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuar në atë kohë edhe tani sipas ligjit të aplikueshëm.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtrueses së kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për pagat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 20.maj. 2011, brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë së tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH "Sharr". Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit dhe

çështja e të provuarit me prova së kërkesa për kompensim për pagat e papaguara nuk është e parashkruar. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati.

Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit e tëra është parashkruar, është plotësisht i saktë. Ankuesi ka dorëzuar prova që vërtetojnë faktin se kishte të themeluar marrëdhënien e punës me të paditurën nga viti 1977, deri kur ishte larguar nga puna në vitin 1997, dhe ankuesi e kishte fituar procesin gjyqësorë dhe ishte kthyer në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës me punëdhënësin, kjo rrethanë nuk është kontestuese.

Mirëpo ankuesi nuk dorëzoi provë së kishte kërkuar përmbushjen e detyrimit të pretenduar pasi që ishte kthyer në vendin e punës, për çdo muaj të kaluar për të cilët nuk ishte paguar paga, pasi që procesin gjyqësor e kishte fituar. Nga kjo rrjedh që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të papaguara veç e veç. Ankuesi kërkesën para AL e ka parashtruar me 20.maj. 2011, që do të thotë se prej muajit gusht të vitit 1997 - shtator të vitin 1999, dhe maj të vitit 2011, kërkesa për pagat e papaguara është parashkruar.

Gjykata konstaton së ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara. Ankuesi po ashtu nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se sa ka qenë paga mujore në të cilën ajo e mbështet ankesën e tij. Pretendimi i ankuesit pa mbështetje në prova është jo relevantë dhe i pa bazuar. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të kërkesës së tij. Kopja e vendimit kur kishte themeluar marrëdhënie punë, si dhe aktgjykimi i plotfuqishëm dhe aktvendimi përmbarrimor, që kishte fituar procesin gjyqësorë për kthimin në vendin e punës, të dorëzuar si provë nga ankuesi nuk mund të shërbejë si provë e vetme për t'ju njohur e drejta e pretenduar në ankesë.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësata apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të papazuara.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të palëve në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të te lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka

G j y q t a r e